

REPublika e Kosovës
REPublika Kos. :
Qendra për Shërbim të Qytetarëve
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 30526
U. _____ Br. _____

Nr. i faq. 1 Data: 22/09
Br. str. _____ Datum: _____
KAMENICË/A 2022



REPublika e Kosovës
REPublika Kosova / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



Duke u bazuar në nenin 68 të Ligjit (Nr.03/L-040) për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 4, 5 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ(MAPL) NR. 06/2018 Për Standardet Minimale Të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe nenit 20 të Statutit të Kamënicës 01.Nr.005 datë 26.09.2008 si dhe Vendimit për Ndryshimin dhe Plotësim të Statutit 01.Nr.15 të datës 31.05.2010, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik thërret:

TAKIM PUBLIK

Për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2027

Duke pas parasysh përmbushjen e kërkesave të qytetarëve dhe zbatimin e dispozitave ligjore, Komuna përdor mekanizmin e konsultimeve dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejt të tyre në propozimet për aktet normative me interes të përgjithshëm për qytetarët siç është hartimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2027.

Takimi publik me qytetarë do të mbahet më datë 03.10.2022 (E hënë), duke filluar nga ora 14:00, në Sallën e Kuvendit Komunal.

Vërejtje; propozimet, sugjerimet dhe komentet e juaja mund t'i dorëzoni në zyrën e (QSHQ-së) kati i parë (I) në objektin e Komunës.

Kryesues i Grupit Punues: